



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të të Dhënave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, *Agjencia e Statistikave të Kosovës*, bënë:

Shpallje të Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri I Institucionit	<i>Agjencia e Statistikave të Kosovës</i>
Titulli i punës:	Zyrtar për statistika të turizmit
Numri i references:	ASK-DSELLK-001
Tarifa e shërbimit:	437.55 Euro (Bruto)
Raporton te:	Udhëheqësi i divizioni-bartësi i projektit
Lloji I kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta - (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	5 muaj
Orari i punës:	I plotë
Lokacioni dhe numri i ekzekutuesve:	ASK-1

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgatitja e pyetësorëve dhe udhëzuesve për mbledhjen e të dhënave për njësite raportuese në Kosovë
- Kontrollimi i mbledhjes së të dhënave nga terreni.
- Kontrollimi i pyetësorëve, kodimi dhe përfshirja e të dhënave.
- Përpunimi dhe analiza e të dhënave.

- Krijimi i bazës së të dhënave për kapacitetet e akomodimit me qëllim të përmirësimit të kornizës së mostrës për statistikat e hotelierisë dhe turizmit.
- Editimi, tabelimi dhe përgatitja e raportit final të hulumtimit.
- Përpunimi, tabelimi dhe publikimi i të dhënave nga anketat sipas tre muajve,
- Përgatitja e raporteve nga të dhënat e grumbulluara .

Shkathtësitë e kërkuara:

- Përgatitja universitare-Fakulteti ekonomik;
- **Përvoja e punës:** kandidati duhet të ketë 2 vite përvojë pune profesionale në fushën relevante.
- **Kompetenca dhe aftësitë:**
- Njohuri të thellë profesionale në fushën e statistikave të hotelierisë dhe turizmit.
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventuale i personelit në nivel profesional;
- Aftësi të njohjes të Gjuhës Angleze
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Azhur dhe i gatshëm në kryerjen e detyrave të punës,
- Entuziast dhe energjik,

Agjencia e Statistikave të Kosovës, mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Konkursi është i hapur 5 ditë kalendarike nga dita e publikimit në web faqen e ASK-se.

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në Arhiven e ASK-se, ose mund të tërhiqen nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr. "Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë.

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen intervistës me gojë.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038- 20031149, prej orës 08:00 – 16: 00.

